



Prishtinë, 28 qershor 2013
Kodi i ZRRE-së: V_541_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej katër (4) njësive gjeneruese; HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC “Bitinja” 2.1 MW, HC “Vica” 2.5 MW dhe HC “Brod” me kapacitet prej 2.5 MW, në total prej 9.57 MW, në komunën e Shtërpcës, të datës 29.03.2013 të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k., me adresë “Veternik”, KK Prishtinë, Republika e Kosovës,
- Kërkesës për pezullim të procedurës së shqyrtimit të pjesës së aplikacionit për njësinë gjeneruese HC “Brod” me kapacitet prej 2.5 MW, të datës 21 qershor 2013, të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k.,

në seancën e mbajtur me datë 28 qershor 2013 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Matkos Group” sh.p.k., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HC “Shtërpce” me kapacitet prej 2.47 MW, HC “Bitinja” 2.1 MW dhe HC “Vica” 2.5 MW, në total prej **7.07 MW**, në komunën e Shtërpcës.
- II.** Aplikantit “Matkos Group” sh.p.k., mund t’i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga Uji.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 29.03.2013 nga ndërmarrja “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HC Shtërpce me kapacitet prej 2.47 MW, HC Bitinja 2.1 MW dhe HC Vica 2.5 MW, në total prej 7.07 MW, në komunën e Shtërpcës.
 - Me datë 21.06.2013 ZRRE nga ndërmarrja “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar kërkesën pezullimin e shqyrtimit të njësisë HC “Brod” me kapacitet prej 2.5 MW, me arsyetim se ekziston konflikt për shkak se në të njëjtin lokacion ka aplikuar edhe një ndërmarrje tjetër për marrje të autorizimit preliminar, andaj kërkon që procedura në lidhje me këtë kërkesë të pezullohet.
 - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimit të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar